



V E N D I M

K.P.P.576/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Përsëritja e shortit të hedhur më datë 28.05.2018 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-39658-12-29-2017 me objekt “*Ruajtja dhe sigurimi fizik i Universitetit të Mjekësisë Tiranë*”, me fond limit 18,202,997 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 07.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

Ankimues:

“Myrto Security” shpk
Lagjia Kastriot, Rruga “Brigada e 11 Sulmuese”, godina e Albtelecom Fier

Autoriteti Kontraktor:

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005-Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:


I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 29.12.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-39658-12-29-2017 me objekt: “Ruajtja dhe sigurimi fizik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”– Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj” me fond limit 18.202.997 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 07.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

II.2. Në datën 07.02.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se në datën 22.02.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Arbana	pa ofertë	I skualifikuar
- SSX	47933.03	I skualifikuar
- Toni Security	7988.2	I skualifikuar

- Firdeus Security	7988.83	I skualifikuar
- ISA	7988.83	I kualifikuar
- Nazeri 2000	7988.83	I kualifikuar
- Oktapus 1 Security	7988.83	I skualifikuar
- Ales	7988.84	I skualifikuar
- Aulona Pol 1	7988.84	I skualifikuar
- Safe	7988.96	I skualifikuar
- Eurogjici Security	7988.96	I skualifikuar
- Dea Security	7989.08	I skualifikuar
- Pelikani Security Group	7990.59	I kualifikuar
- Leksi Security	7990.59	I kualifikuar
- Myrto Security	7990.59	I kualifikuar
- Oktapus	7990.59	I skualifikuar
- Trezhnjeva	7990.59	I skualifikuar

II.4. Në datën 12.03.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Arbana	pa ofertë	I skualifikuar
- SSX	47933.03	I skualifikuar
- Toni Security	7988.2	I skualifikuar
- Firdeus Security	7988.83	I skualifikuar
- ISA	7988.83	I skualifikuar
- Nazeri 2000	7988.83	I skualifikuar
- Oktapus 1 Security	7988.83	I skualifikuar
- Ales	7988.84	I skualifikuar
- Aulona Pol 1	7988.84	I skualifikuar
- Safe	7988.96	I skualifikuar
- Eurogjici Security	7988.96	I skualifikuar
- Dea Security	7989.08	I skualifikuar
- Pelikani Security Group	7990.59	I kualifikuar
- Leksi Security	7990.59	I kualifikuar
- Myrto Security	7990.59	I kualifikuar
- Oktapus	7990.59	I skualifikuar
- Trezhnjeva	7990.59	I skualifikuar

II.5. Referuar parashtrimeve në ankesë si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se më datë 28.05.2018 në ambjentet e Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë është hedhur shorti për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Në datën 29.05.2018, operatori ekonomik ankimues “Myrto Security” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Në vijim të njoftimit tuaj datë 23.05.2018 në datën 28.05.2018 ora 13 nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar u paraqitëm për të qenë pjesmarrës në procedurën e shortit për përcaktimin e operatorit ekonomik fitues të procedurës së prokurimit. Në prani edhe të përfaqësuesve të dy operatorëve të tjerë pjesmarrës fillimisht nga anëtarët e KVO-së u bë e njohur procedura që do të ndiqej për hedhjen e shortit. Shorti do të hidhej me gogla brenda të cilave do të kishte numrat nga 1 deri te 3 (parashorti) Goglat do të hidheshin dy herë herën e parë për të përcaktuar rradhën se kush nga operatorët do të përzgjidhte i pari i dytë dhe i tretë gogël fituese (parashorti) dhe herën e dytë sipas rradhës së përcaktuar do përcaktohej fituesi i shortit. Që në parashortin për të përcaktuar rradhën e përzgjedhjes nga anëtarët e KVO u këmbngul që të drejtën për të përzgjedhur i pari të ishte përfaqësuesi i Pelikani Security me arsyetimin për të respektuar rradhën e renditjes sipas sistemit të APP-së gjë e cila u kundërshtua nga përfaqësuesi ynë i cili kërkoi që operatorët pjesmarrës të viheshin në kushte të barabarta përzgjedhjeje por që nuk u morr në konsideratë nga KVO. Pas hedhjes së shortit për të përcaktuar rradhën e përzgjedhjes së goglës fituese rezultoi se i pari kishte të drejtën e përzgjedhjes përfaqësuesi i operatorit ekonomik Pelikani Security , i dyti përfaqësuesi i Leksi Security dhe i tretë përfaqësuesi i operatorit Myrto Security.
- Me të njëjtat gogla u kalua në hedhjen e shortit për përcaktimin e operatorit fitues ku të drejtën e përzgjedhjes së pari e kishte përfaqësuesi i operatorit Pelikani Security. Pas përzgjedhjes rezultoi se përfaqësuesi i Pelikani Security përzgjodhi goglën që brenda kishte shënimin fitues pra fitues i shortit. Përfaqësuesi i Pelikani Security në të dyja rastet përzgjodhi të njëjtën gogël dhe nga verifikimi fizik nga afër i kësaj gogle nga përfaqësuesi ynë rezultoi se kjo gogël kishte një shenjë e cila e bënte të dallueshme nga dy goglat e tjera. Në këtë moment përfaqësuesi ynë kontestoi procedurën e shortit duke kërkuar hedhjen sërish nga e para e shortit me gogla të tjera. Anëtarët e KVO pasi i morrën nga dora forcërisht goglën me shenjë fillimisht ranë dakord gjë të cilën e deklaroi Kryetari i KVO-së që shorti të përsëritej dhe u kërkuar tre përfaqësuesve të 3 operatorëve të prisnin jashtë ambjenteve ku u hodh shorti. Pas pritjes rreth katër orë rreth orës 16:30 nga KVO na komunikohet që nuk do të ketë short tjetër por do të konsiderohet i vlefshëm procedura që u kontestua prej të cilës u shpall fitues Pelikani Security.
- Duke vlerësuar të gjitha rrethanat: Faktin që edhe në parashort për përcaktimin e rradhës së tërheqjes së goglave me këmbnguljen dhe vendimarrjen e KVO-së ishte përfaqësuesi i Pelikani Security që përzgjodhi i pari.
Faktin që përfaqësuesi i Pelikani Security përzgjodhi në të dyja rastet të njëjtën gogël dhe kjo gogël ishte me shenjë të dallueshme
Faktin që nga anëtarët e KVO goglën me shenjë ja morrën forcërisht nga duart përfaqësuesit tonë
Faktin që nga Kryetari i KVO u deklarua se shorti do të përsëritej por pas katër orësh u vendos se nuk do të kishte short tjetër është lehtësisht e evidentueshme se gjithë procedura e hedhjes së shortit ishte e manipuluar duke pasur si synim të vetëm shpalljen fitues të shortit operatorin ekonomik Pelikani Security. Kërkojmë pranimin e ankesës. Anullimin e shortit datë 28.05.2018.

II.7. Autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2074/110 prot datë 30.05.2018 i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.8. Në datën 01.06.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr.2074/115 prot., datë 08.06.2018 protokolluar me tonën me nr.1038/3 datë 08.06.2018 me objekt “*Dërgohet informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Myrto Security” shpk për anulimin e shortit të datës 28.05.2018 për procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për parregullsi në hedhjen e shortit , nga shqyrtimi në tërësi i ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, Komisioni konsaton se operatori ekonomik ka marrë pjesë në hedhjen e shortit të organizuar nga autoriteti kontraktor në datën 28.05.2018. Referuar procesverbalit të hedhjes së shortit bashkëngjitur informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se në short kanë marrë pjesë edhe operatorët ekonomike “Pelikani Security” shpk dhe “Leksi Security” shpk të cilët rezultojnë me të njëjtën vlerë ekonomike.

III.1.2. Referuar procesverbalit mbi procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e fituesit përcaktohet si vijon: *“Paraqitja e operatorëve ekonomikë duhet të jetë në orën 13 të datës 28.05.2018. Organizimi i parashortit dhe shortit do të jetë me gogla. Operatorët ekonomikë të renditur sipas renditjes zyrtare të APP do të tërheqin njëri pas tjetrit goglat me numrat që do të përcaktojnë rradhën e tërheqjes në shortin përfundimtar. Numrat do të jenë nga një në tre duke qenë se në këtë procedurë janë tri operatorë ekonomikë pjesëmarrës me të njëjtën ofertë ekonomike. Sipas renditjes të përcaktuar në parashortin e hedhur operatorët ekonomikë do të paraqiten njëri pas tjetrit për të zgjedhur secili goglën në shortin përfundimtar. Goglat do të kenë të shkruar Fitues dhe Humbës. Ky procesverbal është i firmosur rregullisht nga të gjitha palët. Operatorët ekonomikë pasi lezimit të këtij procesverbali tërhoqën goglat sipas renditjes së APP ku rezultoi Pelikani security Nr.1, Myrto Security Nr.3, Leksi Security Nr.2. palët janë dakort. Vijon faza e dytë sipas rradhës tërheqin goglat Pelikani Security -*

Fitues, Leksi Security -Humbës, Myrto Security- Humbës.Më pas përfaqësuesi i operatorit ekonomik Myrto tërheq gogllën me forcë dhe pretendon se është me shenjë.

Sa më sipër, KPP konstaton se për fazën e parë operatori ekonomik “Myrto Security” shpk ka firmosur rregullisht procesverbalin dhe e ka pranuar rregullin e vendosur nga KVO, që rradsa e tërheqjes së gogllës do të bëhej sipas renditjes së APP. Ndërsa për fazën e dytë ankimuesi pretendon se gogla i është tërhequr me forcë operatorit fitues ku ka rezultuar me shenjë. Gjithashtu bashkëngjitur ankesës ankimeusi ka bashkëngjitur disa foto të gogllës me shenjë.

III.1.3. Referuar argumentave të ankimuesit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor KP,P gjykon se pretendimet e ankimuesit për ripërsëritjen e shortit me argumentat se gogla e tërhequr nga operatori ekonomik “Pelikani Security” shpk për fazën e dytë kishte shenjë, nuk mund të merren në konsideratë nga Komisioni. Gjithashtu fotot të cilat ankimuesi ka bashkëngjitur ankesës nuk përbëjnë provë për sa kohë që nuk mund të provohet pa asnjë dyshim se këto janë goglat që janë përdorur në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Akoma më tej KPP referuar dokumentimit të të gjithë procesit konstaton se ankimuesi ka marrë pjesë në të dyja fazat e shortit si atë të tërheqjes së gogllës që përcakton rradsën e tërheqjes si atë të përcaktimit të fituesit. Ankimesi ka marrë pjesë deri në fund në proces deri në momentin e tërheqjes së gogllës fituese nga operatori Pelikani Security shpk. KPP gjykon se nëse operatori ekonomik ankimesi ka dyshuar në parregullsinë e goglave duhet të kishte bërë verifikimin paraprak të tyre që në fazën e parë pra në momentin që goglat janë përzjerë, dhe jo pasi shoqëria Pelikani Security shpk tërheq gogllën fituese.

III.1.4. KPP gjykon se operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkellen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për paregullsi në procesin e hedhjes së shortit nga autoriteti kontraktor. Theksojmë se paregullsi të tilla gjatë këtij moment procedural mund të kenë të bëjnë me mosnjohimin në formën e duhur të një apo më shumë operatorëve për të marrë pjesë në short duke përfshirë këtu edhe ankimesin, akoma më tej mund të përbëjë paregullsi pjesëmarrja e ndonjë operatori ekonomik që nuk ka ofertuar me të njëjtën vlerë ekonomike, mungesa e transparencës në procesin e përgatitjes dhe tërheqjes së zarfave apo goglave sikundër në rastin konkret etj. Asnjë nga këto momente nuk evidentohen në ankesë e në këtë kuptim ankimesi nuk provon pretendimin e tij për paregullsi në këtë proces. Duke qene se vetë operatori ekonomik ka marrë pjesë në këtë proces ka pasur mundësinë të përfaqësohet dhe të bëjë zgjedhjen e tij Komisioni gjykon se fakti që nuk është shpallur fitues në këtë procedurë nuk e legjitimon të ngrejë pretendime të cilat nuk i provon me asnjë mjet.

III.1.5. Komisioni sqaron se organizimi i shortit është në diskrecion të plotë të autoritetit kontraktor mjafton që të respektohen hapat proceduralë për njohimin e rregullt të ofruesve për tu dhënë atyre mundësi të marrin pjesë në procedurën e hedhjes së shortit në mënyrë që të garantohet transparenca dhe barazia në trajtimin e ofruesve. Pretendimet e ngritura në ankesë nuk dëshmojnë në asnjë rast për ndonjë paregullsi gjatë hedhjes së shortit as për mos marrje dijeni lidhur me shortin. Sa më sipër

Komisioni nuk evidenton dhe nuk gjen asnjë shkak në ankesë për parregullsi në hedhjen e shortit nga ana e autoritetit kontraktor që të mund të legjitimojë ankimuesin në pretendimet e ngritura në ankesë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Myrto Security” sh.p.k nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Myrto Security” shpk, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-39658-12-29-2017 me objekt “Ruajtja dhe sigurimi fizik i Universitetit të Mjekësisë Tiranë”, me fond limit 18,202,997 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 07.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1038 Protokolli; Datë 01.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha